

# EVIDENTIM I SITUATËS SË SHËRBIMEVE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

## BASHKIA POGRADEC

### STATISTIKA

Numri i personave me aftësi të kufizuara në bashkinë Pogradec është 3738, prej të cilëve, 1,756 janë të regjistruar dhe përfitojnë nga pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar në Bashkinë Pogradec, ndërsa 1982, janë përfitues nga skemat e Sigurimeve Shoqërore për invalidët e punës.

Mazhoranca e përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar janë meshkuj (n=927; 52.7%).

31%,(n=545) e përfituesve nga skemat e pagesave të mbrojtjes sociale për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Pogradecit janë fëmijë të moshës 0-18 vjeç.

25%(n=439;) e përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar, janë edhe përfitues të pagesës së kujdestarisë, 90 prej tyre janë fëmijë.

### SHËRBIMET E OFRUARA NË BASHKINË POGRADEC

#### *Qendra Ditore Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuara*

Në territorin e Bashkisë Pogradec ushtron aktivitetin një qendër ditore për fëmijë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, e cila mbështetet dhe funksionon në ambientet e vëna në dispozicion nga Bashkia Pogradec, të rikonstruara nga UNDP. Qendra ofron shërbim ditor për fëmijë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, të kufizuara. Stafi i qendrës mbështetet financiarisht nga Bashkia Pogradec. 45 klientë me aftësi të kufizuara marrin shërbim në këtë qendër, prej të cilëve 39 janë fëmijë. Qendra është një qendër ditore ku ofrohen këto shërbime: fizioterapi, terapi zhvillimi në grup dhe individuale, klasa speciale mësimore.

#### *Shërbim fizioterapie*

Përmes mbështetjes nga Fondi Social, Bashkia Pogradec ka filluar një shërbim fizioterapie. Ky shërbim ofrohet në një tjetër ambient që ndodhet tek stadiumi i qytetit. Numri i personave që kanë marrë këtë shërbim është 35 persona.

#### *Qendra Drita e Shpresës*

Qendra "Drita e Shpresës" funksionin përmes mbështetjes nga donatorë. Shërbimet e ofruara janë ditore, perkatesisht në fushat: ortopedi, fizioterapi, atelie kreative, logopedi, ndërhyrje e hershme. Bethesda kafe, është një projekt tjetër i qendrës, i cili synon fuqizimin përmes punësimit. Të gjitha projektet/shërbimet plotësojnë njera – tjetren dhe për ofrimin e tyre janë ngritur skuadra multidisciplinare. Numri i përfituesve është 620 në vit, prej të cilëve 159 janë fëmijë.

### NEVOJA PËR SHËRBIME

Mungojnë disa nga shërbimet bazë, të parashikuara në shportën e shërbimeve, dedikuar personave me aftësi të kufizuara.

Është domosdoshmëri shtimi i gamës së shërbimeve komunitare për personat me aftësi të kufizuara, si në numër, por edhe në llojshmëri me qëllim që t'i vijnë në ndihmë të gjithë individëve në nevojë në territorin e Bashkisë Pogradec.

